

## “RAPORT MBI OFRIMIN E NDIHMËS JURIDIKE SHTETËRORE NË SHQIPËRI”<sup>1</sup>

### *Hyrje*

Aksesi i qytetarëve në ndihmën juridike falas është një proces i rëndësishëm për të gjithë ata individë të cilët nuk kanë mundësi financiare për të paguar një avokat privat dhe që kërkojnë të ushtrojnë të drejtat e tyre civile, politike, ekonomike, etj, nëpërmjet zbatimit të procedurave administrative, civile ose penale të parashikuara në legjislacionin e vendit tonë. Në Shqipëri ka disa organizata jo fitimprurëse që ofrojnë shërbime ligjore falas, por duke mbajtur në konsideratë, nga njera anë, përparësitë e secilës organizatë si dhe nivelin e lartë të varfërisë së popullsisë, rezulton se nevojat e përgjithshme të individëve për ndihmë juridike falas nuk mund të mbulohen vetëm nëpërmjet shërbimeve të ofruara nga këto OJF. Në këtë kuadër edhe Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KShH), nëpërmjet programit "Klinika Ligjore Falas", mbështetur financiarisht nga Civil Rights Defenders<sup>2</sup>, prej disa vitesh u ofron qytetarëve, që janë viktimat të shkeljes së të drejtave të njeriut në Shqipëri, falas, një paketë të larmishme shërbimesh ligjore. Në këtë paketë përfshihen shërbime ligjore të tilla si: këshillim ligjor, asistim në përpilimin e dokumentacionit, verifikim ankese, ndërhyrje në institucionet shtetërore, monitorim seance gjyqësore dhe përfaqësim në të trija nivelet e sistemit gjyqësor, në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg.

Për të përmirësuar situatën në drejtim të aksesit në drejtësi, më 22 Dhjetor 2008, Kuvendi i Shqipërisë miratoi Ligjin nr. 10 039, datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike”. Ky ligj përcakton kushtet, llojin, mënyrën dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti, me qëllim mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të individit, si dhe interesave të tjerë të ligjshëm të tij. Ligji e klasifikon ndihmën juridike që do të financojë shteti: a) në parësore dhe b) dytësore. Ndihma juridike parësore është dhënia e informacionit për sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, për aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore, si dhe dhënia e asistencës në hartimin e dokumenteve juridike apo në forma të tjera. Ndihma juridike dytësore është dhënia e shërbimeve të këshillimit, përfaqësimit apo mbrojtjes në proceset gjyqësore penale, proceset gjyqësore civile dhe administrative, si dhe të paraqitjes para organeve administrative shtetërore.

Ligji përcakton si institucione përgjegjëse për administrimin e shërbimit të ndihmës juridike Ministrinë e Drejtësisë, Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe Komisionin Shtetëror për Ndihmën Juridike. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike (KShNJ) është organ shtetëror kolegjal, i cili përbëhet nga 5 anëtarë, 1 përfaqësues i Ministrisë së Drejtësisë, 1 përfaqësues i Ministrisë së Financave, 1 përfaqësues i Dhomës Kombëtare të Avokatisë, 1 përfaqësues i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe 1 nga organizatat e shoqërisë civile. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike kryesohet nga znj. Blegina Kodra, në cilësinë e Kryetares së këtij Komisioni.

Ky raport ka si objekt të analizojë në këndvështrimin teorik dhe praktik çështje lidhur me zbatueshmërinë e Ligjit “Për Ndihmën Juridike” dhe veprimtarinë e Komisionit Shtetëror

<sup>1</sup> Monitorim i veprimtarisë së Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike (KShNJ)

<sup>2</sup> Ish Swedish Helsinki Committee

për Ndhimën Juridike. Qëllimi i këtij raporti është të evidentojë se sa efektive është aktualisht ndihma juridike shtetërore në Shqipëri dhe të adresojë disa nga nevojat kryesore që duhet të zgjidhen, me përparësi, në të ardhmen. Metodologjia e ndjekur për hartimin e këtij raporti është marrja e informacionit nëpërmjet takimeve të zhvilluara me anëtarë të Komisionit për Ndhimën Juridike dhe stafit të institucionit, si dhe analizës së akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi lidhur me ofrimin e ndihmës juridike shtetërore.

### ***Konsiderata të Përgjithshme mbi Funkcionimin e Ndhimës Juridike Shtetërore***

Edhe pse kanë kaluar 3 vjet nga miratimi i ligjit "Për Ndhimën Juridike", KShH vëren se zbatimimi i këtij ligji është duke u kryer me hapa të ngadalta. Angazhimi i strukturave përgjegjëse shtetërore për zbatimin e ligjit nuk ka qenë në nivelin e duhur dhe faktorët që kanë ndikuar në ngadalësinë e këtij procesi kanë qenë kryesisht të natyrës tekniko – organizative, të tilla si mungesë koordinimi dhe bashkëpunimi, buxhet i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat për burimet njerëzore dhe materiale, mungesë e infrastrukturës dhe aktesh nënligjore etj.

Veprimtaria e deritanishme e institucioneve shtetërore përgjegjëse për zbatimin e ligjit të sipërshënuar, gjatë vitit 2011, ka qenë kryesisht e karakterit organizativ. Keshilli i Ministrave me anë të vendimit nr.98, date 9.2.2011 miratoi strukturën e Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike dhe organiken përkatëse të sekretariatit të tij, ndërkohë që Ministria e Drejtësisë i ka miratuar këtij institucionit rregulloren e brendshme të tij<sup>3</sup>.

Pjesë e rëndësishme e veprimtarisë për zbatimin e ligjit "Për ndihmën ligjore" ka qenë hartimi dhe miratimi i disa vendimeve të rëndësishme nga organi vendimmarrës I KShNJ. Organizata "Shërbimi Ligjor Falas Tiranë" (TLAS), misioni i huaj në Shqipëri "EURALIUS" dhe organizatat e tjera të shoqërisë civile kanë bashkëpunuar dhe kanë dhënë një ndihmesë të madhe për hartimin e këtyre vendimeve.

Megjithë hapat e rëndësishme të ndërmarra, deri më sot, për zbatimin e ligjit "Për Ndhimën Juridike" KShH konstatoi se, deri më sot, asnjë individ nuk ka përfituar ende nga ndihma juridike shtetërore. Nevojat e qytetarëve për shërbime ligjore falas kanë vazhduar të mbulohen vetëm nga OJF-të e specializuara në këtë fushë, nëpërmjet burimeve të tyre të kufizuara njerëzore dhe materiale. Gjithashu, KShH vëren se, pavarësisht nga fakti se ligji "Për ndihmën juridike" ka parashikuar mirë dhe qartazi kompetencat e institucioneve përgjegjëse, bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punës midis këtyre institucioneve duhet të forcohet më tej. KShH sugjeron që këto institucione të nënshkruajnë marrëveshje ose memorandume bashkëpunimi, të cilat të rregullojnë në mënyrë të detajuar bashkëpunimin e tyre në nivel institucional dhe masat që do ndërmerren nga secili institucion për të garantuar rritjen e efektivitetit të ndihmës juridike shtetërore.

### ***Aktet Juridike të Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike***

Organi vendimmarrës i Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike, bazuar në kompetencat që i jep ligji, ka miratuar 5 vendime, të cilat parashikojnë një rregullim më të detajuar për sa i takon përparësive në lidhje me ofrimin e ndihmës juridike shtetërore për periudhën 2011-

---

<sup>3</sup> Miratuar me Urdhër Nr. 7301/3, datë 19.01.2012

2012; kriteret që duhet të plotësojnë avokatët, zyrat e avokatisë dhe OJF-të që do të ofrojnë ndihmë juridike të financuar nga shteti; procedurën që duhet të ndjekin individët që kërkojnë të marrin ndihmë juridike falas; masën e shpërblimit të avokatëve dhe kriteret për vlerësimin e ndihmës juridike të ofruar nga këto subjekte.

Konkretisht, KShNJ ka miratuar vendimet si më poshtë vijojnë:

**Vendimi nr.1, datë 25.06.2011** përcakton prioritetet që do ndiqen për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore gjatë vitit 2011 dhe 2012. Prioritetet janë vendosur në fushën e së drejtës civile, familjare, marrëdhënieve të punës, sigurimet shoqërore, si dhe për rastet e diskriminimit në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit që KShNJ ka nënshkruar me Komisionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**Vendimi nr.2, datë 25.06.2011, marrë bashkarisht nga KShNJ dhe Dhoma Kombëtare e Avokatisë,** përcakton rregullat dhe procedurën që do të ndiqet për caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike. Sipas këtij vendimi, transparenca, konkurrenca e hapur, ofrimi i shërimit nga më shumë se një subjekt, profesionalizmi dhe mosdiskriminimi janë disa nga parimet bazë që duhet të udhëheqin KShNJ-në dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë në caktimin e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe organizatave jofitimprurëse që do të ofrojnë ndihmë juridike.

**Vendimi nr.3, datë 25.06.2011 i KShNJ,** miraton modelin e formularit të kërkesës dhe dokumentat që duhet t'i bashkëngjiten këtij formulari nga individë që i drejtohet KShNJ-së për përfitimin e ndihmës juridike shtetërore. Në rastet kur individë kërkon ndihmë juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë për një çështje civile ose administrative, ai duhet të plotësojë vetë ose me anë të përfaqësuesit të tij formularin tip të kërkesës sipas kriterëve të përcaktuara në këtë vendim. Kur kërkuesi paraqet kërkesë për dhënie të ndihmës juridike në format e tjera, të parashikuara në ligjin "Për ndihmën juridike", formulari plotësohet nga personi i autorizuar nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike ose avokati. Në këtë vendim përcaktohet edhe lista e dokumentave që kërkuesi i ndihmës juridike duhet t'i bashkëlidhë formularit të kërkesës. Ndër të tjerash, kërkuesi duhet të paraqesë dokumenta që vërtetojnë se ai përfshihet në programet e mbrojtjes sociale ose plotëson kushtet e mëposhtme për t'u përfshirë në to. Në rast se kërkuesi plotëson kushtet për tu përfshirë në programet e mbrojtjes sociale ai duhet të paraqesë 7 vërtetime, përkatësisht nga Zyra e Punës, Zyra e Tatim – Taksave, Zyra e Sigurimeve Shoqërore, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra e Regjistrimit të Automjeteve, Seksionet përkatëse pranë Bashkisë ose Komunës ku kanë vendbanimin e tyre, nëse janë subjekte të regjistruara pranë tyre dhe Inspektoriati i Punës, nëse rezultojnë të punësuar informalisht.

**Vendimi nr.4, datë 25.06.2011 i KShNJ-së** rregullon metodën e vlerësimit dhe të përcaktimit të masës së shpërblimit të avokatëve që do të ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe dytësore në fushën civile dhe administrative. Masa e shpërblimit të avokatëve përcaktohet me pike. Vlera e një pike është 1000 Lek. Pikët përlllogariten në funksion të karakterit të çështjes dhe shërbimit juridik të ofruar.

**Vendimi nr.5, datë 25.06.2011 i KShNJ-së** përcakton kriteret, standardet dhe format e kontrollit të cilësisë në ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore me qëllim garantimin e standardeve më të larta të profesionalizmit për aksesin real dhe efektiv në

drejtësi. Komisioni Shtetëror i Ndhmës Juridike është organi përgjegjës që verifikon dhe kontrollon cilësinë e ndihmës juridike të ofruar nga avokatët. KShNJ i dërgon rezultatet e kontrollit pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë të Shqipërisë, e cila i trajton ato sipas parashikimeve mbi “procedurën e ankimit dhe disiplinimit të avokatëve” bazuar në Ligjin për Profesionin e Avokatit në Republikën e Shqipërisë, Kodin Etik dhe Statutit të Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Për sa më sipër, Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson punën e KShNJ-së, Dhomës Kombëtare të Avokatisë dhe Ministrisë së Drejtësisë për sa i takon hartimit dhe miratimit të akteve juridike të mësipërme. KShH vlerëson veçanërisht kontributin dhe ekspertizën e ofruar nga Shërbimi Ligjor Falas Tiranë dhe Misioni EURALIUS gjatë procesit të hartimit të këtyre akteve. Megjithatë, KShH dëshiron të pasqyrojë disa konstatime dhe sugjerime në lidhje me përmbajtjen e këtyre akteve dhe zbatueshmërisë së tyre në praktikë.

### ***Konstatime e sugjerime:***

- Komisioni Shtetëror për Ndhmën Juridike ende nuk ka filluar të zbatojë procedurat e parashikuara në vendimin nr.2 për përzgjedhjen e avokatëve, zyrave të avokatisë dhe OJF që do të ofrojnë ndihmë juridike për individët në nevojë. Procedurat priten të fillojnë në muajin janar të vitit 2012. KShH vlerëson se mbajtja pezull e këtyre procedurave për një periudhë 6 mujore mbas miratimit të vendimit nr.2 të KShNJ-së, ka ndikuar negativisht në efektivitetin e ndihmës juridike të ofruar nga shteti dhe në realizimin e aksesit në drejtësi të shtetasve pa të ardhura të mjaftueshme.
- Komiteti Shqiptar i Helsinkit vlerëson prioritetet e përcaktuara në vendimin nr.1 të KShNJ-së, ku ndihma juridike për vitet 2011-2012 do të fokusohet në disa çështje që mbulohen nga e drejta civile, familjare, marrëdhëniet e punës dhe sigurimet shoqërore. Megjith, bazuar në eksperiencën e deritanishme KShH vëren se ka edhe çështje të tjera prioritare, kryesisht në lëmin penal dhe marrëdhëniet e qytetarëve/punonjësve me administratën publike të cilat kanë një numër të lartë kërkesash për ndihmë juridike, të cilat kanë ngelur jashtë skemës së prioritetëve të përcaktuara në vendimin nr.1.
- Vendimi nr.3 i KShNJ-së parashikon se për kërkesat për dhënien e ndihmës juridike në formën e përfaqësimit në gjykatë, për një çështje civile ose administrative, kërkuesi apo përfaqësuesi i tij, i autorizuar me prokurë, duhet të plotësojnë formularin tip të kërkesës. Sipas vendimit nr.3, respektimi i formës për këtë lloj ndihme juridike është kusht për vlefshmërinë e kërkesës. Ndërkohë vendimi nr.2 i KShNJ-së parashikon se avokati i vënë në dispozicion nga KShNJ duhet të ndihmojë kërkuesin e ndihmës juridike që të plotësojë formularin për kërkimin e ndihmës juridike në formën e “përfaqësimit në gjykatë për çështjet civile dhe administrative”. KShH sugjeron që të ketë një rregullim ligjor më të qartë të kësaj procedure, qoftë edhe në këndvështrimin praktik, pa qenë e nevojshme të bëhen ndryshime në vendime, në mënyrë që kërkuesve që paraqesin kërkesë për përfaqësim në gjykatë, për çështjet civile ose administrative, t'u jepet asistencë e nevojshme për plotësimin e formularit. Veçanërisht kjo asistencë është e nevojshme për grupet vulnerable, si shtetas shumë të varfra të popullsisë dhe me nivel të ulët arsimor, anëtarët e minoritetit rom, etj.

- Vendimi nr.3 i KShNJ-së paraqet një listë të gjatë dokumentash që kërkuesi i ndihmës juridike duhet të paraqesë në mënyrë që të përfitojë nga çdo lloj forme të ndihmës juridike shtetërore. Në këndvështrimin praktik dhe ekonomik, KShH vëren se individët do të kenë vështirësi në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar si për sa i takon aspektit kohor dhe atij financiar. Presupozohet që individët që i drejtohen KShNJ-së janë në pamundësi financiare dhe përgjithësisht përfaqësojnë shtresat e varfëra të popullsisë prandaj mbulimi i kostos financiare për sigurimin e dokumentacionit shpesh është i pamundur. Për më tepër, për shërbime të thjeshta ligjore të tilla si: sigurimi i informacionit juridik apo dhënia e këshillave dhe shpjegimeve të çështjeve juridike, intervistave të drejtpërdrejta apo komunikimit në distancë, plotësimi i dokumentacionit të kërkuar përbën një kërkesë burokratike që do të ndikojë negativisht në shpejtësinë dhe efektivitetin e këtyre formave të ndihmës juridike. Gjithashtu, plotësimi i dokumentacionit është i vështirë për t'u zbatuar për personat e privuar nga liria të cilët ndodhen në institucionet e paraburgimit dhe institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale. KShH vlerëson se procedura është një mjet shumë i rëndësishëm që garanton ushtrimin e të drejtës, mgjth sugjerojmë që për raste dhe kategori të caktuara të popullsisë, veçanërisht të atyre që janë me liri të kufizuar ose të sëmurë e në pamundësi për të lëvizur, me paaftësi të përhershme etj si këto, të ketë përjashtime për aspektet formale të paraqitjes së kërkesës dhe dokumentacionit që duhet të paraqesin, me qëllim sigurimin e shpejtë dhe efektiv të ndihmës juridike shtetërore.

### ***Sensibilizimi i qytetarëve***

Sensibilizimi i qytetarëve për ekzistencën dhe përmbajtjen e Ligjit "Për Ndhmën Juridike" është një proces informimi që ka si synim ndërgjegjësimin e tyre për të aksesuar format e ndryshme të ndihmës juridike shtetërore që ligji parashikon. Neni 11, pika 2 e Ligjit "Për Ndhmën Juridike" parashikon se ndihma juridike jepet edhe nëpërmjet edukimit ligjor të publikut, përmes ndihmës që i ofrohet komunitetit me klinika lëvizëse, publikime, fushata televizive dhe në median e shkruar, si dhe masa të tjera të ngjashme, duke u kushtuar vëmendje të veçantë problemeve të grupeve më në nevojë.

KShNJ ka përgatitur një broshurë informuese në bashkëpunim me Shërbimin Ligjor Falas Tiranë (TLAS) për sa i takon veprimtarisë së KShNJ-së dhe ndihmës juridike shtetërore. Në vitin 2012 është parashikuar të zbatohet një projekt pilot në 5 qytete të Shqipërisë nëpërmjet të cilit do bëhet shpërndarja e formularit tip të kërkesës për ndihmën juridike në dhomat e avokatisë në qytete dhe në organet e pushtetit vendor. KShH vëren se sensibilizimi i deritanishëm i qytetarëve për ligjin "Për ndihmën juridike" është shumë i ulët dhe institucionet shtetërore përgjegjëse nuk kanë marrë masat e nevojshme për të bashkërenduar veprimtaritë e tyre me qëllim sensibilizimin dhe edukimin ligjor të publikut. Gjithashtu qytetarët nuk kanë informacionin e nevojshëm për sa i takon përparësive të ndihmës juridike, procedurës që duhet të ndjekin për ta përfituar atë dhe dokumentacionit që duhet të plotësojnë. Tregues i këtij konstatimi është edhe numri i vogël i kërkesave për ndihmë juridike të paraqitura në KShNJ. Ky institucion referon se ka pasur përafërsisht 23 kërkesa për ndihmë juridike, nga të cilat 13 kanë qenë për çështje penale dhe 10 për çështje civile. Sipas KShNJ-së personave nuk u është akorduar ndihmë juridike si rezultat i mangësisë në dokumentacionin e paraqitur nga personat fizikë që kanë kërkuar ndihmën juridike.

### ***Bashkëpunimi i KShNJ-së me Organizatat Jofitimprurëse***

Ligji "Për ndihmën juridike" i atribuon një rol të rëndësishëm organizatave jofitimprurëse që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore si në aspektin vendimarrës, bashkëpunues, në përfshirjen për ofrimin e ndihmës juridike të financuar nga shteti etj.

Neni 6 i Ligjit "Për ndihmën juridike" parashikon se një nga anëtarët e organit vendimarrës të KShNJ-së është përfaqësues nga organizatat jofitimprurëse që veprojnë në fushën e ndihmës ligjore. Aktualisht këtë rol e luan një përfaqësues i organizatës Shërbimi Ligjor Falas Tiranë (TLAS). Neni 19 i ligjit "Për ndihmën juridike" parashikon se "*Organizatat jofitimprurëse, të specializuara në fushën e dhënies së ndihmës juridike, japin ndihmë juridike me avokatë, duke respektuar përcaktimet e bëra në këtë ligj. Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike lidh kontratë bashkëpunimi me këto organizata, për të mundësuar dhënien e ndihmës juridike, në përputhje me format dhe kushtet e parashikuara nga ky ligj*". Neni 6 i vendimit nr.2 të KShNJ-së përcakton kriteret që duhet të përmbushin OJF-të që dëshirojnë të ofrojnë ndihmë juridike të financuar nga shteti dhe dokumentacionin që duhet të paraqesin në KShNJ për këtë qëllim. Procedurat e aplikimit për OJF-të ende nuk janë hapur, sikurse për avokatët dhe zyrat e avokatisë.

KShH vlerëson se në Shqipëri veprojnë disa organizata jofitimprurëse që ofrojnë shërbime ligjore falas, të cilat kanë kapacitete shumë të mira në këndvështrimin cilësor në këtë fushë dhe për këtë arsye mund të legjitimohen si ofruese të ndihmës juridike të financuar nga shteti. KShH vëren se niveli i bashkëpunimit midis këtyre organizatave dhe institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e ligjit në fjalë është në nivel të ulët. Aktivitetet e përbashkëta midis OJF-ve dhe këtyre institucioneve kanë qenë shumë të pakta në numër dhe përgjithësisht kanë qenë nismë e shoqërisë civile.

### **Rekomandime**

- I sugjerohet Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike, Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomën Kombëtare të Avokatisë të forcojnë bashkëpunimin e mëtejshëm me synim sigurimin efektiv të zbatimit të kompetencave të tyre, në përputhje me ligjin "Për ndihmën Juridike".
- I sugjerohet Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike të vlerësojë, në përputhje me nevojat reale, kostot e nevojshme për ofrimin, nga ana e shtetit, të ndihmës juridike dhe t' i paraqiten në kohën e duhur Ministrisë së Drejtësisë për t'i përfshirë në Buxhetin e Shtetit. Në vlerësimin e kostove dhe shpenzimeve të nevojshme të parashikohet edhe zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuese në lidhje me ndihmën juridike shtetërore dhe aktivitete bashkëpunimi midis aktorëve shtetërorë e privatë, që kanë në fokus të punës së tyre ndihmën juridike, me qëllim rritjen e aksesit të qytetarëve në këtë shërbim.
- I sugjerohet Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike të fillojë sa më shpejt të jetë e mundur zbatimin e procedurave të parashikuara në vendimet e miratuara me qëllim fillimin e ofrimit të ndihmës juridike për individët.
- I sugjerohet Ministrisë së Drejtësisë dhe Komisionit Shtetëror për Ndihmën Juridike që të konsultojnë edhe një herë prioritetet e ofrimit të ndihmës juridike, veçanërisht për të ardhmen, me një grup më të gjerë aktorësh, përfaqësues të institucioneve shtetërore,

shoqërisë civile dhe grupeve të interesit.

- I sugjerohet Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike që t'i ofrojë asistencën e nevojshme grupeve vulnerabël të popullsisë, si shtresat shumë të varfra dhe me nivel të ulët arsimor, anëtarët e minoritetit rom, etj, për plotësimin e formularit tip të kërkesës për ndihmë juridike, lidhur me përfaqësimin në gjykatë në çështjet civile dhe administrative.
- I sugjerohet Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike të parashikojë në vendimin nr.3 të tij, përjashtime për detyrimin e dorëzimit të dokumentacionit të kërkuar për personat që plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në programet e mbrojtjes sociale. Të sigurohen zgjidhje të tjera alternative për sigurimin e këtij dokumentacioni, pa kosto dhe pa angazhim kohor të personave që kanë nevojë, nëpërmjet vendosjes së urave të bashkëpunimit midis Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike dhe institucioneve që kanë të drejtë të lëshojnë këtë dokumentacion. Të parashikohen përjashtime për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar kur individit kërkon forma të thjeshta të ndihmës juridike si këshillim apo konsulencë ligjore e cila do të rrisë aksesin e qytetarëve në përfitimin e këtyre shërbimeve.
- I sugjerohet Komisionit Shtetëror për Ndhimën Juridike të vendosë kontakte dhe marrëveshje bashkëpunimi me të gjitha OJF-të që veprojnë në fushën e ndihmës juridike me qëllim bashkërendimin e përpjekjeve të shumëanshme për të siguruar efektivitetin e ndihmës juridike falas në Shqipëri. Kjo mund të realizohet nëpërmjet zhvillimit të veprimtarive të përbashkëta për sensibilizimin e qytetarëve dhe edukimin ligjor të tyre (*fushata ndërgjegjësuese në media, street law, publikime etj*), zhvillimin e debateve dhe tryezave të rrumbullakta, inicimin e nismave të reja ligjore ose diskutimin e nevojave për ndryshimet në legjislacionin ekzistues të ndihmës juridike me qëllim përmirësimin e tij në të ardhmen etj.
- KShH sugjeron, që për të ardhmen, prioritetet e ndihmës juridike të konsultohen në një nivel më të gjerë aktorësh, përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile dhe grupeve të interesit.